



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 12, datë 04.06.2024

PËR

**“PËRDORIMIN E KOMISONIT TË PËRFITUAR SI AGJENT TATIMOR,
NGA AKEP, NË FORMËN E SHPËRBLIMIT PËR VËSHTIRËSI NË PUNË,
PËR VITIN 2024”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z.Tomi Frashëri	Kryetar
2. Znj. Edlira Dvorani	Anëtar
3. Z. Armer Juka	Anëtar
4. Z. Lorenc Bako	Anëtar
5. Z. Bleron Dokle	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taci, në mbledhjen e datës 04 / 06 / 2024, konform procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Mbi përdorimin e komisionit të përfitur si agjent tatimor, nga AKEP, në formën e shpërblimit për vështirësi në punë, për vitin 2024;**

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 dhe 3 e nenit 114, pika 3, e nenit 117, të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në RSH” (**ligji 9918/2008**);
2. Pika 4, e nenit 2, pika 3 e nenit 8, si dhe gërma e), e nenit 11, të Ligjit Nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar. (**ligji nr. 9975/2008**);
3. Pika 1.b) e nenit 5 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9920/2008**);

4. Pika 1 e nenit 8 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar (*ligji 10296/2010*);
5. VKM Nr. 803, datë 28.12.2023, “Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2024”;
6. Pika 3 dhe pika 6 e Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe AKEP, Nr. 30, datë 23.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit”, i ndryshuar;
7. Seksioni 1 i Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 26, datë 04.09.2008 “Për Taksat kombëtare”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 27 datë 16.12.2014;
8. VKD nr.15 datë 24.10.2023, “Për caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe Projekt Buxhetin e vitit 2024 të AKEP”;
9. VKD nr. 93, datë 10.12.2018, “Për, vendosjen e rregullave për mënyrën e buxhetimit, raportet e përdorimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues në miradministrimin dhe menaxhimin e komisionit të përfutur nga AKEP në cilësinë e tij Agjent Tatimor, për mbledhjen e tarifave kombëtare”

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni Shpjegues/Shoqërues i projekt vendimit të përgatitur nga DJI dhe DBMF (*Relacioni*);
2. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar, si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, bazuar në legjislacionin që rregullon procedurat tatimore në RSH, është përcaktuar institucioni publik në rolin e Agjentit Tatimor, përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin e të ardhurave nga tarifa për shërbimet e radiokomunikimit në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore, për t’u transferuar më pas në Buxhetin e Shtetit, mbështetur kjo në nenin 11/e, të Ligjit nr. 9975/2008. Në vijim, si dhe referuar Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të Kryetarit të KD-së së AKEP, nr.30, datë 23.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit”, i ndryshuar, është përcaktuar niveli minimal i tarifës së shërbimit të radiokomunikimit, si dhe komisionet përkatëse të përfutur nga AKEP në funksionin e agjentit tatimor për mbledhjen e tarifës për shërbimet e radiokomunikimit.
2. Në pikën 6 të Udhëzimit të sipërcituar, është përcaktuar se AKEP-për shërbimet e kryera përfiton në masën 5% komision të vete llogaritur prej tij, mbi vlerën e tarifave të llogaritura, ndërkohë që transferon 95 % të vlerës në Buxhetin e Shtetit. Mbledhja dhe transferimi i tarifave dhe taksave në buxhetin e shtetit, është detyrë që e kryen agjenti tatimor, referuar përcaktimeve ligjore

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

parashikuara në pikën 1.b), neni 5, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilave *agjenti tatimor është personi që mbledh dhe transferon në Buxhetin e Shtetit tatimet dhe taksat.*

3. Në vëmendje të sa më sipër, AKEP me VKD nr. 93, datë 10.12.2018, “Për, vendosjen e rregullave për mënyrën e buxhetimit, raportet e përdorimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues në miradministrimin dhe menaxhimin e komisionit të përftuar nga AKEP në cilësinë e tij Agjent Tatimor, për mbledhjen e tarifave kombëtare”, ka sanksionuar ndër të tjera modalitetet dhe procedurat e përdorimit të këtij komisioni, duke konsideruar themelore tre kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi (**Ligji nr.9975/2008**).
4. Në këtë kontekst, me VKD nr. 15, datë 24.10.2023, “Për caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe Projekt Buxhetin e vitit 2024 të AKEP”, është vendosur se nga vlera 23.5 milion lekë e parashikuar të përftohet nga AKEP si Agjent Tatimor, për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin e tarifës së radio komunikimit, vlera prej 14.1 milion lekë do të përdoren si shpërblim për vështirësi në punë për vitin 2024, për punonjësit e AKEP.

Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP gjykon se:

5. Këshilli Drejtues i AKEP në referim të dispozitave ligjore të lartpërmendura, duke analizuar nevojat, si dhe duke parë përparësitë për përdorimin e komisionit të përftuar si agjent tatimor për mbledhjen e tarifës së radio komunikimit, vlerëson tërësisht legjitime dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi përdorimin në masën parashikuar në fondin e shpenzimeve administrative të AKEP të komisionit në fjalë, në formën e shpërblimit për vështirësi në punë.
6. Përfshirja e gjithë punonjësve të AKEP për ushtrimin e detyrave dhe mbartjen e përgjegjësive të përcaktuara ligjërisht për agjentin tatimor, duke u bazuar në specifikën e tarifës për shërbimin e radio komunikimit, nuk mund të konsiderohet një veprim i thjeshtë llogaritës, por një procedurë e lidhur ngushtë me gjithë procesin e zbatimit të detyrave dhe ushtrimin e kompetencave nga strukturat e AKEP, në përputhje me ligjin nr. 9918/2008. Për këto arsye, zgjidhja me e mirë në funksion të arritjes në një nivel sa më të lartë të të ardhurave të arkëtuara nga tarifa për shërbimin e radio komunikimit, është ndërthurja e detyrave funksionale të çdo punonjësi të AKEP sipas pozicionit të punës, me detyrat e parashikuara ligjërisht për agjentin tatimor. Në këtë mënyre edhe përgjegjësia për të siguruar një rol sa më aktiv, profesional dhe rezultativ të AKEP-it si agjent tatimor, unifikohet me përgjegjësinë e përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive ligjore të çdo punonjësi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, në pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Përdorimin në vlerën prej 14.1 milion lekë të komisionit të përfituar si agjent tatimor në formën e shpërblimit për vështirësi në punë, për vitin 2024, për punonjësit e AKEP.
2. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Tomi Frashëri



Edlira Dvorani



Armer Juka



Lorenc Bako



Bleron Dokle

